

Vendim nr. 223 datë 08.10.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtar
Illir Toska,	Anëtar

në datën 08.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 13 (F) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **FATIME DEHARAJ (LIMANI)**, përfaqësuar nga avokatët Pjetër Ndreca dhe Agim Çela, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 1014 (86-2023-1357), datë 07.12.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-1448, datë 08.04.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si dhe të 6 akteve të Ministrisë së Financave, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Shfuqizimi i togfjalëshit “pa praninë e palëve” në paragrafin 6 të nenit 480 të Kodit të Procedurës Civile, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, duke e zëvendësuar me togfjalëshin “me praninë e palëve, kryesisht të avokatëve të tyre”.

BAZA LIGJORE: Nenet 33, pika 1, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, pika 1 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Fatime Deharaj është motra e të ndjerit Xh.L. Ata dhe shtetasja H.S. janë fëmijë të të njëjtëve prindër. Nga ana tjetër, nëna e tyre L.L., nga një martesë tjetër, ka pasur edhe pesë fëmijë, një djalë dhe katër vajza.

2. Vëllai i kërkueses, shtetasi Xh.L., me vendimin nr. 186, datë 14.07.1951 të Gjykatës Territoriale Ushtarake Tiranë është dënuar me 17 vjet heqje lirie, punë të detyruar dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet, për veprën penale të dezertimit. Po kështu, me vendimin nr. 189 të korrikut 1954 të Gjykatës së Lartë, ky shtetas është dënuar me 25 vjet heqje lirie për veprën penale të pjesëmarrjes në një organizatë kundër pushtetit popullor me qëllim arratisjen dhe, në bashkim të dënimeve, ai është dënuar përfundimisht me 25 vjet heqje lirie. Në vijim, me vendimin nr. 185, datë 09.05.1980 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shtetasi Xh.L. është dënuar sërish me 10 vjet heqje lirie për veprën penale të agjitacionit dhe propagandës. Ai ka ndërruar jetë i ve në datën 26.04.1985, ndërsa vuante dënimin. Me vendimin nr. 3, datë 06.12.1995 të Komisionit Shtetëror Trepalësh, atij i është dhënë statusi i ish të përndjekurit politik, bazuar në ligjin nr. 7748, datë 29.07.1993 “Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”.

3. Në datën 12.11.2007 ligjvënësi ka miratuar ligjin nr. 9831 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist” (*ligji nr. 9831/2007*), që ka për objekt, ndër të tjera, përcaktimin e përfituesve, masës, kritereve dhe procedurës së përfitimit të dëmshpërblimit financiar për ish të dënuarit politikë, të cilët kanë vuajtur persekutimin e drejtpërdrejtë në regjimin komunist, nëpërmjet kryerjes së dënimeve penale të padrejta, si burgim ose masa mjekësore të detyrueshme, si pasojë e një apo disa vendimeve penale të formës së prerë të gjykatave të zakonshme, gjykatave speciale apo të urdhrave të organeve të hetuesisë, gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 01.10.1991 (*neni 1*). Sipas këtij ligji, për sa i përket dëmshpërblimit për të burgosurit politikë, në rastin kur i dënuari nuk jeton më, ai u takon në pjesë të barabarta familjarëve të tij (*neni 6*), ku me familjarë nënkuptohen, pavarësisht nga rregullime të tjera ligjore, vetëm paraardhësit, bashkëshortja, fëmija/fëmijët, ndërsa familjarët, në shkallë më të parë, sipas Kodit Civil (*KC*), përjashtojnë familjarët e tjerë (*neni 8*). Ligji ka

përcaktuar Këshillin e Ministrave si autoritetin përgjegjës për miratimin e dëmshpërblimit financiar (*neni 9*), ndërsa për shpërndarjen e dëmshpërblimit ka ngarkuar Ministrinë e Financave (*neni 13*).

4. Në zbatim të ligjit nr. 9831/2007 Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 382, datë 19.05.2010 “Për miratimin e dëmshpërblimit financiar për ish të dënuarit politikë të regjimit komunist” (*VKM nr. 382/2010*), ku përfshihej edhe dëmshpërblimi për shtetasin Xh.L., në vlerën 13 656 137 lekë. Ndërkohë, në lidhje me familjarët përfitues, sikundër dhe për sa i përket procesit të shpërndarjes së dëmshpërblimit, kanë lindur mosmarrëveshje.

Mosmarrëveshja për familjarët përfitues

5. Me dëshminë noteriale të trashëgimisë nr. 107, datë 01.11.1994, si trashëgimtare ligjore të trashëgimlënësit Xh.L., janë përcaktuar dy motrat e tij, kërkuesja dhe H.S. Ndërkohë, me vendimin nr. 243, datë 20.06.1995, Gjykata e Rrethit Bulqizë ka lëshuar dëshminë e trashëgimisë ligjore të trashëgimlënësit Xh.L., duke përcaktuar si trashëgimtarë të tij, krahas kërkueses dhe H.S., edhe katër motra dhe një vëlla të tij nga nëna.

6. Kërkuesja ka paraqitur një padi për njohjen e pavërtetësisë së vendimit nr. 243, datë 20.06.1995 të Gjykatës së Rrethit Bulqizë, ndërkohë që e paditura Z.N., motra e saj nga nëna, ka paraqitur kundërpadi për pavlefshmërinë e dëshmisë noteriale të trashëgimisë nr. 107, datë 01.11.1994. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin nr. 530(596-33-2011), datë 23.09.2011, ka vendosur: (i) pushimin e padisë së kërkueses, si padi që nuk mund të ngrihej; (ii) pranimin e kundërpadisë, duke deklaruar absolutisht të pavlefshëm dëshminë noteriale të trashëgimisë nr. 107, datë 01.11.1994. Sipas asaj gjykate, vendimi gjyqësor për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë nuk mund të kundërshtohet me padi, ndërsa dëshmia noteriale e trashëgimisë është lëshuar nga noteri në kapërcim të kompetencave të tij referuar rregullimeve të kohës së KC-së, përveçse edhe në mashtrim, pasi noterit nuk i janë vënë në dispozicion të gjitha dokumentet e nevojshme për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë. Ajo gjykatë ka vlerësuar se trashëgimtarët e njohur me vendimin nr. 243, datë 20.06.1995 të Gjykatës së Rrethit Bulqizë janë motra dhe vëllezër të një nëne, por të dy baballarëve të ndryshëm, duke qenë të gjithë ata trashëgimtarë të radhës së tretë të trashëgimlënësit Xh.L., sipas nenit 364 të KC-së. Kundër këtij vendimi kërkuesja ka ushtruar ankim, ndërsa e paditura/kundërpaditëse Z.N. ka paraqitur apel kundërshtues.

7. Ndërsa çështja si më lart ndodhej për shqyrtim në gjykatën e apelit, mbi kërkesën e kërkueses, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2337, datë 12.03.2012, ka

lëshuar dëshminë e trashëgimisë ligjore të trashëgimlënësit Xh.L., duke përcaktuar si trashëgimtare të tij dy motrat, kërkuesen dhe H.S, referuar për këtë certifikatave të gjendjes civile të administruara në gjykim.

8. Ndërkohë, në vijim të shqyrtimit të ankimit të kërkueses, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 850, datë 11.04.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

Mosmarrëveshja për procesin e shpërndarjes së dëmshpërblimit

9. Pas miratimit të VKM-së nr. 382/2010, kërkuesja i është drejtuar Ministrisë së Financave me kërkesë për transferimin e dëmshpërblimit në llogarinë e saj. Në datën 25.05.2012 kërkueses i ka kaluar kësti i parë i dëmshpërblimit, ndërsa në vijim, Drejtoria e Pagesave dhe Dëmshpërblimeve në Drejtorinë e Thesarit të Ministrisë së Financave (DPD) nuk ka vijuar me pagesën e këstit të dytë. Sipas DPD-së, në dosjen e dëmshpërblimit gjendeshin dy akte trashëgimie që nuk përcaktonin të njëjtët trashëgimtarë për të ndjerin Xh.L. Kërkuesja i është drejtuar disa herë Ministrisë së Financave për kryerjen e pagesës së këstit të dytë të dëmshpërblimit dhe me shkresat nr. 3073/2 prot., datë 03.03.2016; nr. 4005/1 prot., datë 23.03.2016; nr. 4005/3 prot., datë 01.04.2016; nr. 4005/7 prot., datë 05.05.2016 dhe nr. 4005/10 prot., datë 16.06.2016, DPD-ja e ka informuar fillimisht atë se nuk mund të procedonte me pagesën e këstit të dytë të tij, për shkak të dy vendimeve gjyqësore që ishin në kundërshtim me njëri-tjetrin për sa i përket rrethit të trashëgimtarëve të shtetasit Xh.L. dhe se pagesa e radhës do të bëhej pas depozitimit të një vendimi të formës së prerë për këtë çështje. Në vijim, DPD-ja ka informuar kërkuesen se situata ligjore e trashëgimtarëve të ligjshëm të Xh.L. ishte saktësuar me vendimin nr. 850, datë 11.04.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë, me të cilin ishte përcaktuar shtatë trashëgimtarë ligjorë të tij, pa bërë dallim nëse ishin të njëjti apo vetëm të një nëne, si rrjedhim i gjithë përfitimi duhej të ndahej në pjesë të barabarta për secilin prej tyre, ndërsa vendimi i gjykatës së apelit ishte i formës së prerë. Po kështu, DPD-ja ka informuar kërkuesen se për pretendimet në lidhje me veprimet e saj, mund t'u drejtohej institucioneve kompetente.

10. Duke mos qenë dakord me veprimet e Ministrisë së Financave, kërkuesja i është drejtuar gjykatës administrative me padi, përmes së cilës ka kërkuar detyrimin e asaj ministrie për të vazhduar me ekzekutimin e dëmshpërblimit deri në përfundimin e tij, me pretendimin se ky ekzekutim duhej të bëhej në favorin e saj, si trashëgimtare e të ndjerit Xh.L., ndërsa ajo kishte përfituar dhe këstin e parë të dëmshpërblimit. Në përfundim të gjykimit, Gjykata

Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 6139 (80-2016-6009), datë 13.12.2016, ka vendosur rrëzimin e padisë, duke vlerësuar se Ministria e Financave kishte vepruar në zbatim të ligjit dhe se ishte detyrë e kërkueses të plotësonte dosjen me dokumentacionin e nevojshëm me qëllim që ministria të vijonte me pagesën e këstit të dytë.

11. Mbi ankimin e kërkueses, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1014(86-2023-1357), datë 07.12.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë, duke i vlerësuar të drejta përfundimet e saj. Kurse për rekursin e kërkueses, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1448, datë 08.04.2024, në dhomën e këshillimit, bazuar në nenet 1, pika 2 dhe 63, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*), si dhe në nenin 480 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se në rekurs nuk ngriheshin shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012. Në datën 08.07.2024 kërkuesja e ka kundërshtuar këtë vendim me një kërkesë drejtuar Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për të cilën nuk ka marrë ndonjë përgjigje.

12. Në vijim, në datën 06.08.2024, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili pas plotësimit, sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 02.09.2024.

II

Pretendimet e kërkueses

13. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

A. *Për procesin gjyqësor:*

13.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

13.1.1. *Parimit të sigurisë juridike* në aspektin e “*gjësë së gjykuar*”, pasi Ministria e Financave dhe gjykatat e zakonshme kanë anashkaluar vendimin nr. 2337, datë 12.03.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, aktin noterial nr. 107, datë 01.11.1994, si dhe faktin e pagesës nga Ministria e Financave të këstit të parë të dëmshpërblimit financiar. Vendimet nr. 243, datë 20.06.1995 të Gjykatës së Rrethit Bulqizë, nr. 530, datë 29.11.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër dhe nr. 850, datë 11.04.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë janë akte të falsifikuara dhe në mashtrim të ligjit. Futja e tyre në dosjen e saj është bërë nga specialistja e Ministrisë së

Financave, duke konsumuar disa vepra penale. Shkresat e Ministrisë së Financave, të mbështetura në këto vendime gjyqësore, janë absolutisht të pavlefshme. Për më tepër, me vendimin nr. 6775, datë 22.12.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur sërish se familja e të ndjerit përbëhej nga 5 anëtarë, konkretisht i ndjeri, nëna dhe babai i tij, si dhe dy motrat, kërkuesja e shtetasja H.S. Rekursi i kërkueses nuk është marrë në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, në veçanti nga ndihmësmagjistrati, duke vepruar në kundërshtim me vendimin nr. 1/2006 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në lidhje me interpretimin e nenit 494, shkronja “e”, të KPC-së.

13.1.2. *Së drejtës për t’u dëgjuar*, pasi ajo nuk është njoftuar nga Gjykata Administrative e Apelit për seancën e datës 07.12.2023. Kjo gjykatë nuk ka proceduar me shpalljen e njoftimit të datës së seancës në mjediset e gjykatës administrative të shkallës së parë, si dhe nuk e ka njoftuar për seancën në banesën e saj ose adresën elektronike të mbrojtësit të saj. Po kështu, në datën 18.03.2024 ajo është njoftuar në rrugë elektronike nga Gjykata e Lartë për shqyrtimin e rekursit të saj në datën 08.04.2024, pa praninë e palëve.

13.1.3. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i datës 17.01.2024 i gjyqtarit relator në Gjykatën Administrative të Apelit, për pranimin e rekursit të kërkueses, shfaq kontradikcion të hapur me qëndrimin e këtij gjyqtari në vendimin nr. 1014, datë 07.12.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë që rrezonte kërkesëpadinë e saj, por edhe me vendimin e Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit. Kjo e fundit në arsytimin e vendimit të saj ka përdorur fjalën “seleksionim”, e cila nuk parashikohet në dispozitat kushtetuese dhe ligjore, duke krijuar kështu perceptimin se rekursi është shqyrtuar pa vëmendje, kujdes, seriozitet dhe korrektësi.

13.2. *Së drejtës së pronës*, pasi aktet e Ministrisë së Financave dhe vendimet e kundërshtuara të gjykatave prej 9 vjetësh kanë cenuar interesat e ligjshme financiare të saj.

B. Për shfuqizimin e dispozitave:

13.3. Neni 480 i KPC-së, në pjesën që parashikon shqyrtimin e rekursit pa praninë e palëve, bie ndesh me nenin 31, pika 1, të Kushtetutës, që parashikon se kushdo ka të drejtë të dëgjohet përpara se të gjykohet, nenin 61, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 49/2012, si dhe nenet 17, 18, 19, 20/1 dhe 26/1 të KPC-së.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkueses

14. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të parashikuara në nenin 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

15. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pranuar se, krahas vendimit gjyqësor, objekt i ankimit kushtetues individual, mund të jetë edhe ligji ose akti normativ. Në këto raste, nisur nga përmbajtja e normave kushtetuese dhe atyre ligjore, kërkuesi legjitimohet nëse plotësohen bashkërisht këto kriteret: (i) legjitimitimi *ratione personae*, në kuptimin që individi provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar, si dhe provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese; (ii) shterimi i mjeteve juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose individi provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; (iii) legjitimitimi *ratione temporis*, në kuptimin që individi ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit; (iv) legjitimitimi *ratione materiae*, në kuptimin që individi provon se pretendimet e ngritura janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, pra të drejtat dhe liritë themelore, që pretendohen se janë cenuar, janë të garantuara në Kushtetutë, si dhe shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur (*shih*

vendimet nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese).

16. Në rastin konkret, Kolegji vëren se, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, kërkuesja, si individ, legjitimohet *ratione personae* në lidhje me vendimet gjyqësore të kundërshtuara, pasi ka qenë palë në proces dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar. Po kështu, ajo legjitimohet *ratione personae* edhe në lidhje me kërkesën për shfuqizimin e shprehjes “pa praninë e palëve” në nenin 480 të KPC-së, pasi kjo dispozitë ka gjetur zbatim në shqyrtimin e çështjes së saj nga Gjykata e Lartë.

17. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji evidenton se objekt i ankimit kushtetues individual të kërkueses janë vendimet e dhëna gjatë procesit gjyqësor të kundërshtuar, ashtu edhe procesi administrativ i kryer nga Ministria e Financave. Për sa u përket pretendimeve në lidhje me procesin administrativ, Kolegji konstaton se kërkuesja i ka parashtruar ato përpara gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, të cilat kanë mbajtur qëndrim në lidhje me to. Ndërsa, sa u përket pretendimeve në lidhje me procesin gjyqësor, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të tij në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se për këto pretendime kërkuesja nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual, ndërsa ligji procedural nuk parashikon mjet tjetër ankimi. Për sa u përket pretendimeve të kërkueses në lidhje me shfuqizimin e togfjalëshit përkatës në nenin 480 të KPC-së, Kolegji konstaton se kjo dispozitë nuk parashikon nxjerrjen e akteve nënligjore dhe është zbatuar drejtpërdrejt nga Gjykata e Lartë në procesin e zhvilluar ndaj saj, për rrjedhojë çmon se kërkuesja ka shteruar mjetet juridike efektive edhe për sa i përket këtij kërkimi.

18. Në drejtim të legjitimitimit *ratione temporis*, Kolegji vëren se neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Po kështu, neni 50, pika 4, i ligjit nr. 8577/2000 parashikon se individët mund të paraqesin kërkesë për papajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara brenda 4 muajve nga konstatimi i cenimit. Në rastin e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se konstatimi i cenimit, si rregull, nuk përkon me çastin e hyrjes në fuqi të ligjit ose aktit normativ, por ai llogaritet nga çasti kur akti fillon të prodhojë efekte për kërkuesin ose, e thënë

ndryshe, kur ndaj tij zbatohet ligji ose akti normativ (*shih vendimin nr. 41, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në çështjen në shqyrtim, Kolegji evidenton se kërkesja nuk e ka kundërshtuar përmbajtjen e dispozitës ligjore drejtpërdrejt në Gjykatë, por së bashku me vendimin gjyqësor të Gjykatës së Lartë, të dhënë në zbatim të saj, ndaj afati ligjor 4-mujor për kundërshtimin e saj llogaritet nga data e këtij vendimi, i cili përbën edhe vendimin e fundit gjyqësor për çështjen e saj. Në rastin konkret, vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 08.04.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 06.08.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

20. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të sigurisë juridike dhe atij të ligjshmërisë, së drejtës për t'u dëgjuar (nga Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë), standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, si dhe së drejtës së pronës, pretendime të cilat *prima facie* përfshihen në juridiksionin kushtetues. Për sa i përket së drejtës për t'u dëgjuar nga Gjykata e Lartë, kërkesja ka pretenduar se ajo i është cenuar edhe për shkak të përmbajtjes së ligjit, konkretisht togfjalëshit “pa praninë e palëve” në nenin 480 të KPC-së.

21. Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar, si aspekt i procesit të rregullt ligjor, kërkesja ka parashtruar se Gjykata Administrative e Apelit nuk e ka njoftuar për datën e seancës, sipas ligjit. Po sipas saj, çështja është gjykuar në Gjykatën e Lartë pa praninë e palëve.

22. Kolegji vëren se neni 49 i ligjit nr. 49/2012 përcakton se shqyrtimi i çështjeve nga Gjykata Administrative e Apelit bëhet, si rregull, mbi bazë të dokumenteve në dhomën e këshillimit dhe në seancën gjyqësore, me prani të palëve, nëse gjykata vlerëson se është përpara ndonjë prej rasteve të parashikuara nga neni 51, pika 1, i po këtij ligji. Në lidhje me Gjykatën e Lartë, ky ligj rregullon posaçërisht procedurën e gjykimit të çështjeve, ndërsa pas ndryshimeve të bëra në vitin 2021 nuk ka ndonjë dispozitë që rregullon shqyrtimin paraprak të rekursit në lidhje me pranueshmërinë e tij. Pavarësisht kësaj, sipas nenit 1, pika 2, të këtij ligji, dispozitat e tij plotësohen me parashikimet e KPC-së, neni 480 i saj rregullon shqyrtimin paraprak të rekursit. Në këtë dispozitë përcaktohet se shqyrtimi i rekursit bëhet në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se procesi gjyqësor konsiderohet i rregullt, për sa kohë që në një shkallë gjykimi është zhvilluar në seancë gjyqësore publike, gjatë së cilës kërkesit i është dhënë mundësia për t'u dëgjuar dhe mbrojtur

(shih vendimet nr. 27, datë 18.05.2023; nr. 28, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese). Në rastin konkret, Kolegji konstaton se shqyrtimi i çështjes së kërkueses në gjykatën administrative të shkallës së parë është bërë në prani të përfaqësueses së saj, duke iu dhënë mundësia në këtë mënyrë për të parashtruar pretendimet për çështjen. Po kështu, gjykimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit dhe në Gjykatën e Lartë është vënë në lëvizje nga kërkuesja, përmes ankimit dhe rekursit. Duke pasur parasysh parashikimet ligjore konkrete dhe faktin që këto gjykata kanë mbajtur qëndrim në lidhje me pretendimet e saj, Kolegji vlerëson se kërkuesja nuk ka arritur të përcaktojë cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar në aspektin kushtetues, si rrjedhojë e mosnjohimit të pretenduar prej saj për datën e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit ose për shqyrtimin e rekursit në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve. Për rrjedhojë, pretendimi i saj për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar, si aspekt i procesit të rregullt ligjor, nuk mund të merret në shqyrtim nga Gjykata.

23. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar nga Gjykata e Lartë, për shkak të përmbajtjes së ligjit, kërkuesja ka parashtruar se togfjalëshi “pa praninë e palëve”, në paragrafin 3 të nenit 480 të KPC-së, bie ndesh me nenin 31, pika 1, të Kushtetutës, sipas së cilës: “*Kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohet.*”. Kjo dispozitë, ashtu si edhe dispozitat pararendëse të saj, bëjnë fjalë për procesin penal, ndërkohë që në rastin konkret jemi përpara një procesi gjyqësor të një natyre tjetër (administrativ). Po kështu, kërkuesja ka parashtruar se përmbajtja e dispozitës ligjore të kundërshtuar, sipas saj, bie ndesh me disa dispozita të tjera ligjore. Kolegji vëren se për sa i përket së drejtës për t'u dëgjuar, Gjykata e ka trajtuar si aspekt të së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, për të cilin, sikurse edhe më lart u parashtrua, ajo është shprehur se procesi gjyqësor konsiderohet i rregullt, për sa kohë që në një shkallë gjykimi është zhvilluar në seancë gjyqësore publike. Ndërsa sa i përket përplasjes mes ligjeve, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se mënyra e të kuptuarit, e të zbatuarit të ligjit dhe harmonizimit ndërmjet dispozitave të tij me ligje të tjera, nuk janë çështje që i përkasin kontrollit kushtetues, për rrjedhojë nuk janë objekt shqyrtimi nga Gjykata (shih vendimet nr. 9, datë 01.03.2021; nr. 5, datë 05.02.2015; nr. 2, datë 03.02.2010 të Gjykatës Kushtetuese). Për rrjedhojë, në mungesë të argumenteve kushtetuese, Kolegji vlerëson se edhe pretendimet e kërkueses për kundërshtimin e përmbajtjes së nenit 480 të KPC-së nuk mund të merren në shqyrtim nga Gjykata.

24. Lidhur me pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, kërkuesja ka parashtruar dy argumente. Sipas saj, ka kontradiksion të hapur në qëndrimin e

gjqtarit të relator në Gjykatën Administrative të Apelit, i cili me vendimin e datës 17.01.2024 ka vendosur pranimin e rekursit, me atë në vendimin nr. 1014, datë 07.12.2023 të asaj gjykate, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit të gjykatës së shkallës së parë për themelin e çështjes. Kolegji vëren se, referuar neneve 57 dhe 60 të ligjit nr. 49/2012, rekursi ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit depozitohet në këtë gjykatë dhe se gjyqtari i vetëm i kësaj gjykate ose relatori që ka dhënë vendimin verifikon nëse rekursi përmbush kërkesat formale të përcaktuara nga ligji, duke vendosur për pranimin e rekursit, plotësimin e tij në rastin e të metave ose kthimin e rekursit kur të metat nuk janë ndrequr në afatin e caktuar. Në këndvështrim të këtij parashikimi ligjor, Kolegji vëren se vendimi për pranimin e rekursit nga gjyqtari i relator që ka dhënë vendimin në Gjykatën Administrative të Apelit është i një natyre të ndryshme me atë të vendimit i cili kundërshtohet përmes rekursit, përveçse ky vendim i tij është në funksion të garantimit të aksesit të individëve në Gjykatën e Lartë. Në këtë kuptim, Kolegji çmon se pretendimi i kërkueses për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor për këtë shkak nuk gjen mbështetje në aspektin kushtetues.

25. Po kështu, sipas kërkueses, ka kontradikcion të hapur mes vendimit të datës 17.01.2024 të gjyqtarit të relator në Gjykatën Administrative të Apelit, për pranimin e rekursit, me vendimin e Gjykatës së Lartë që ka vendosur mospranimin e rekursit të saj. Kolegji vëren se dy vendimet në fjalë nuk janë në kontradiktë mes tyre. Në rastin e pranimin të rekursit gjyqtari relator në Gjykatën Administrative të Apelit ka verifikuar dhe arritur në përfundimin se rekursi plotëson kërkesat formale të ligjit, kurse në rastin e mospranimin të rekursit Gjykata e Lartë, në përputhje me kompetencën e saj për shqyrtimin e kritereve të pranueshmërisë së rekursit, ka verifikuar shkaqet e ngritura në të, duke arritur në përfundimin se ato nuk përfshihen në rastet për të cilat, sipas ligjit, mund të bëhet rekurs. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se edhe ky pretendim i kërkueses, për këtë shkak, nuk gjen mbështetje në aspektin kushtetues.

26. Për sa u përket pretendimeve të kërkueses në lidhje me fjalën “seleksionim” të përdorur në arsyetimin e vendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Lartë, Kolegji sjell në vëmendje se ajo është pranuar edhe nga jurisprudenca kushtetuese. Kështu, Gjykata ka pohuar se veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit të Gjykatës së Lartë është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj (*shih vendimet nr. 31, datë 29.05.2023; nr. 26, datë 27.03.2017; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë këndvështrim, Kolegji çmon se edhe pretendimet e kërkueses për

cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, për këtë shkak, nuk gjejnë mbështetje në aspektin kushtetues.

27. Kërkuesja, gjithashtu, ka ngritur pretendime edhe në lidhje me veprimtarinë e këshilltarit ligjor të Gjykatës së Lartë. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se kjo veprimtari ka karakter këshillues dhe ndihmës, në ndryshim nga ajo e gjyqtarit, e cila ka karakter vendimmarrës. Rregullat procedurale që normojnë veprimtarinë e Gjykatës së Lartë kanë përcaktuar në mënyrë të qartë rolin dhe pozicionin, si dhe kompetencat e këshilltarit ligjor gjatë procesit të vendimmarrjes (*shih vendimet nr. 49, datë 05.10.2023; nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Po sipas Gjykatës, kur pretendimet e ngritura kanë të bëjnë me mospërputhje në linjë dhe në arsytim ndaj akteve të brendshme me natyrë përgatitore dhe ndihmuese dhe vendimeve përfundimtare, kontrolli kushtetues ushtrohet vetëm ndaj këtyre të fundit (*shih vendimin nr. 4, datë 31.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në rastin konkret, Kolegji vlerëson se ky pretendim i kërkueses nuk i nënshtrohet vlerësimit kushtetues.

28. Në përmbledhje të sa më lart, Kolegji çmon të analizojë në vijim pretendimet e kërkueses në drejtim të së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspekt të parimit të sigurisë juridike, argumentet në thelb për të cilin lidhen me arsytimin e vendimeve gjyqësore të kundërshtuara. Kërkuesja ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës së pronës private, argumentet për të cilin janë të ndërvarura me atë për cenimin e procesit të rregullt ligjor, ndaj Kolegji vlerëson se çështja duhet të trajtohet në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona private nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës private ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Për rrjedhojë, duke mbajtur në konsideratë argumentet e paraqitura nga kërkuesja, Kolegji vlerëson se pretendimet më lart të saj të trajtohen në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e sigurisë juridike dhe të drejtën e pronës private.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e sigurisë juridike dhe të drejtën e pronës private

29. Kërkuesja ka pretenduar se Ministria e Financave ka refuzuar të vijojë me pagesën e këstit të dëmshpërblimit që i takonte për të nga vëllai i saj si ish i dënuar politik i regjimit komunist, ndonëse me vendim gjyqësor të formës së prerë gjykatat kishin njohur si trashëgimtare të vetme të tij, nënën dhe babanë, të cilët kishin ndërruar jetë, si dhe 2 motrat e tij, respektivisht kërkuesen dhe shtetasen H.S. Vendimet e gjykatave, që përcaktonin si

trashëgimtarë të të ndjerit edhe shtetas të tjerë, ishin dhënë në mashtrim të ligjit dhe pas marrjes formë të prerë të vendimit nr. 2337, datë 12.03.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që njihje atë dhe motrën e saj si trashëgimtare ligjore të të ndjerit.

30. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar vazhdimisht rëndësinë e parimit të sigurisë juridike, si një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës, duke e parë të lidhur me parimin *res judicata*, sipas të cilit vendimi gjyqësor i formës së prerë është shprehje dhe konkretizim i së drejtës për marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t'i japë jo vetëm qartësi, por edhe siguri kësaj marrëdhënieje. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues e ligjorë, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike (*shih vendimet nr. 22, datë 29.09.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 50, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi gjyqësor i formës së prerë është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin, si dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Sipas Gjykatës, parimi i gjësë së gjykuar është element themelor i gjykimit të drejtë (*shih vendimet nr. 81, datë 18.12.2017; nr. 10, datë 13.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Për sa u përket të drejtave të fituara, si element i parimit të sigurisë juridike, Gjykata është shprehur se çdo proces ku vihen në dyshim të drejtat e fituara, nuk mund të konsiderohet se qëndron jashtë nocionit të “procesit të rregullt”, përderisa diskutohet e vendoset lidhur me këto të drejta të fituara. Ky parim është i detyrueshëm të respektohet në të gjitha fazat e një procesi ku pretendohet cenimi i të drejtave të fituara dhe siguria juridike që rrjedh prej tyre (*shih vendimet nr. 22, datë 29.09.2022; nr. 10, datë 13.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Në rastin konkret, Kolegji vëren se procesi gjyqësor është vënë në lëvizje nga kërkesja për kundërshtimin e mosveprimit të Ministrisë së Financave për pagesën e dëmshpërblimit, në favor të saj, sipas ligjit nr. 9831/2007 dhe detyrimin e këtij organi publik për të kryer këtë veprim. Në analizë të parashikimeve ligjore përkundrejt veprimeve të kryera nga Ministria e Financave, gjykata administrative e shkallës së parë e ka vlerësuar të drejtë e të bazuar në ligj mosveprimin e kësaj të fundit në drejtim të asaj çka i është kërkuar nga kërkesja. Sipas gjykatës, ishte detyrë ligjore e kësaj të fundit të vinte në dispozicion të ministrisë aktet e kërkuara nga ligji nr. 9831/2007, në mënyrë që të procedohej me pagesën e kështit të dytë të dëmshpërblimit, ndërkohë që ministria nuk ishte bërë pengesë për vijimin e procedurave. Në lidhje me pretendimet e kërkeses, për sa i përket vendimit të formës së prerë nr. 2337, datë 12.03.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjykata administrative e shkallës së parë ka vënë në dukje se ky vendim është trajtuar nga Gjykata e Apelit Tiranë në

vendimin nr. 850, datë 11.04.2012, ku është arritur në përfundimin se ai ishte marrë në kundërshtim me ligjin. Po sipas gjykatës administrative të shkallës së parë, vendimi dhe arsyetimi i Gjykatës së Apelit Tiranë ka rëndësi në lidhje me parimin e sigurisë juridike, ndërsa është pikërisht ky vendim që përbën *res judicata*. Për rrjedhojë, ka arsyetuar ajo gjykatë, janë të pabazuara pretendimet e kërkuases se ajo dhe e motra janë trashëgimtarët e vetme ligjore të trashëgimlënësit Xh.L.

33. Edhe Gjykata Administrative e Apelit e ka gjetur të pabazuar ankimin e kërkuases, duke i vlerësuar të drejta e në përputhje me ligjin material dhe atë procedural si veprimet administrative të Ministrisë së Financave, ashtu edhe vendimin e gjykatës administrative të shkallës së parë, duke ndjekur të njëjtën linjë arsyetimi si kjo e fundit. Ndërkohë, ligjshmëria e vendimeve të dy gjykatave më të ulëta i është nënshtruar në vijim vlerësimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili, në kuadër të shqyrtimit paraprak të pranueshmërisë së rekursit të kërkuases, ka vlerësuar se në përmbajtjen e tij nuk përcaktohej asnjë prej rasteve të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012, të cilët të bënin të cenueshëm, në thelb, vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit.

34. Në analizë të vendimeve të mësipërme të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, Kolegji konstaton se pretendimet e kërkuases për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të sigurisë juridike kanë të bëjnë, në thelb, me proceset gjyqësore civile të vëna në lëvizje nga ajo dhe subjektet e tjera, për sa i përket përcaktimit nga gjykatat e zakonshme të rrethit të trashëgimtarëve ligjorë të të ndjerit Xh.L. Ndonëse këto vendime janë bërë objekt analize dhe vlerësimi nga Ministria e Financave dhe gjykatat e zakonshme gjatë procesit gjyqësor administrativ të vënë në lëvizje nga kërkuësja, për detyrimin e asaj ministrie për të kaluar në llogarinë e saj pjesën e mbetur të dëmshpërblimit, Kolegji thekson se objekt i vlerësimit konkret të tij janë vendimet gjyqësore që kanë vendosur në lidhje me këtë proces, pra atë administrativ. Për sa i përket këtij procesi, Kolegji çmon se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, brenda funksioneve të tyre ligjore dhe kushtetuese për zbatimin e interpretimin e legjislacionit në fuqi, kanë dhënë përgjigje të arsyetuar në lidhje me mosveprimet e institucionit shtetëror për pagesën e dëmshpërblimit, duke çmuar se Ministria e Financave kishte vepruar sipas ligjit, si dhe se ishte kërkuësja e cila duhej të vinte në dispozicion të këtij institucioni aktet që përcaktonin në mënyrë përfundimtare rrethin e trashëgimtarëve të të ndjerit. Ato gjykata i kanë dhënë përgjigje edhe pretendimit të kërkuases në lidhje me cenimin e parimit të sigurisë juridike, përfundim ky që, në kontekst të rrethanave të rastit konkret, nuk bie ndesh me kuptimin e parimit të “gjësë së gjykuar” nisur nga natyra deklarative e vendimit nr. 2337,

datë 12.03.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërsa ai është dhënë në një gjykim pa palë kundërshtare, pra në një gjykim jokontencioz.

35. Për sa më sipër, Kolegji çmon se pretendimet e kërkueses për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e sigurisë juridike dhe të drejtën e pronës private, janë haptazi të pabazuara.

36. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.